



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 21.02.2023

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si mëposhtë vijon :

I. DREJTORIA E FINANCËS

➤ SEKTORI I KONTABILITETIT

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

➤ Detyrat kryesore:

1. Siguron ardhjen e dokumentacionit financiar nga Drejtoritë e tjera të AZHBR- së, për të gjitha veprimet financiare të ekzekutuara me të tretët.
2. Kontrollon për saktësinë e dokumentacionit të ardhur në sektor duke firmosur dhe procesverbalet përkatëse në momentin që vijnë në sektor. Në rast mosrakordimesh kërkohet informacion shtesë dhe raportohet tek Përgjegjësi i sektorit të kontabilitetit.
3. Rakordon llogaritë e bilancit në fund të vitit.
4. Krijon llogaritë dhe regjistron veprimet në sistemin e kontabilitetit nën mbikqyrjen e përgjegjësit të sektorit të kontabilitetit, sipas kriterëve të përcaktuara në manual dhe formateve përkatëse.
5. Raporton te Përgjegjësi i sektorit parregullsi të konstatuara gjatë procesit të punës në lidhje me mospërputhje të dhënash apo dokumentacioni, me qëllim përmbushjen e misionit të sektorit.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.

5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 37/2015, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II)”;
- Ligjin nr. 30/2016, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për RSH, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit, në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (IPARD)”;
- Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 24.02.2023, ora 14:00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUIQËSOR DHE RURAL

